




Institucionet e Përkohshme Vetëqeverisëse / Privremena Institucija Samouprave / Provisional Institutions of Self Government
Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo
Ministria e Shërbimeve Publike / Ministarstvo javnih službi / Ministry of Public Services

Seria 5: Statistikat Sociale

Statistikat e Standardit Jetësor 2003-2005




Enti i Statistikës së Kosovës
Zavod za Statistiku Kosova
Statistical Office of Kosovo



Institucionet e Përkohshme Vetëqeverisëse / Privremena Institucija Samouprave / Provisional Institutions of Self Government
Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo
Ministria e Shërbimeve Publike / Ministarstvo javnih službi / Ministry of Public Services

Seria 5: Statistikat Sociale

Statistikat e Standardit Jetësor 2003-2005



Enti i Statistikës së Kosovës
Zavod za Statistiku Kosova
Statistical Office of Kosovo

Botuesi: Enti i Statistikës së Kosovës (ESK)

Data e botimit: Gusht 2007

© : Enti i Statistikës së Kosovës

Riprodhimi autorizohet nëse tregohet burimi.

E shtypur nga: K.G.T, Prishtinë, Kosovë

Informata të shumta janë në dispozicion në internet,
ku mund të qaseni përmes veb-faqes së ESK-së
në internet: www.ks-gov.net/esk

Parathënie

Qëllimi i publikimit të Statistikave të Standardit jetësor është që të ofrojmë të dhëna statistikore lidhur me standardin jetësor në Kosovë, kryesisht lidhur me buxhetin e ekonomive shtëpiake si dhe të dhënat lidhur me varfërinë.

Në këtë publikim janë përmbledhur të dhëna për konsumin, shpenzimet, të ardhurat, si dhe të dhënat për varfërinë për periudhat 2003-2005.

Për grumbullimin e të dhënave, ESK-ja ka përdorur Anketën mbi Buxhetin e Ekonomisë Shtëpiake (ABESH). Përmes këtij publikimi është synuar zbutja e mungesës së informacioneve në fushën e standardit jetësor në Kosovë.

Besojmë se ky publikim do të shërbejë si bazë e dobishme referuese për të gjithë shfrytëzuesit e të dhënave statistikore. Ftojme të gjithë shfrytëzuesit e këtij publikimi për bashkëpunim. Komentet dhe propozimet tuaja mund të na i përcjellin në email adresën: [email: social@ks-gov.net](mailto:social@ks-gov.net), me çka do të kontribuoni në ngritjen e kualitetit të publikimeve në të ardhmen.

Në përgatitjen e këtij publikimi kanë kontribuar punonjësit e sektorit të Statistikave të Standardit jetësor:

1. Mr sc Bashkim Bellaqa – Drejtor i Departamentit të Statistikave Sociale,
2. Emine Deliu – Shefe e sektorit të standardit jetësor
3. Bekim Canolli – Zyrtar i lartë i sektorit të standardit jetësor,
4. Hatixhe Januzaj - Zyrtare e sektorit të standardit jetësor
5. Mevlyde Dehari - Zyrtare e sektorit të standardit jetësor

Përkrahje profesionale për zhvillimin e ABESH (Anketa e Buxhetit të Ekonomive Shtëpiake) kanë ofruar Organizata SIDA dhe Banka Botërore (BB).

Veçanërisht falënderojmë ekspertët për mbështetje profesionale nga (BB) Z. Andrew Dabalen, Z. Sasun Tsirunyan, dhe Anna Gueorguieva, si dhe ekspertët e organizatës Suedeze SIDA Z. Lars Lundgren, z. Claes Andersson dhe Z. Ronnie Andersson.

Falënderojmë punëtorët e zyrave rajonale pranë ESK-së, për anketimin e ekonomive shtëpiake.

Lista e shkurtesave

ABESH	Anketa mbi buxhetin e ekonomive shtëpiake
SIDA	Agjencioni ndërkombëtar për zhvillim dhe bashkëpunim
BB	Banka Botërore
ESK	Enti i Statistikës së Kosovës
IÇK	Indeksi i çmimeve konsumuese
LLK	Llogaritë Kombëtare
BE	Bashkimi Evropian
KKIQ	Klasifikimi i Konsumit Individual sipas Qëllimit

Përmbajtja

	Faqe
HYRJE.....	5
1 Konsumi i ekonomive shtëpiake në Kosovë 2003-2005.....	6
1.1. Konsumi i përgjithshëm.....	7
1.2. Ushqimi.....	8
1.3. Banimi.....	9
1.4. Rrobat dhe veshmbathjet.....	10
1.5. Transporti.....	10
1.6. Mobilet.....	11
1.7. Konsumi “kryesor”.....	11
1.8. Alkooli dhe duhani.....	12
1.9. Shëndetësia.....	13
1.10. Komunikacioni.....	13
1.11. Rekreacioni.....	14
1.12. Arsimi.....	14
1.13. Hotele dhe restorante.....	15
1.14. Mallra të tjera.....	15
1.15. Konkluzion.....	16
2 Konsumi privat në Kosovë 2003-2005.....	17
2.1. Trendet e konsumit.....	17
2.2. Shpërndarja e konsumit.....	18
2.3. Konsumi i ushqimit.....	19
2.4. Konsumi dhe shpenzimet.....	20
3 Të hyrat private në Kosovë 2003-2005.....	21
3.1. Të hyrat kryesore të ekonomive familjare.....	21
3.2. Burimet e të hyrave individuale.....	22
3.3. Nivelet e të hyrave.....	24
3.4. Pabarazia gjinore.....	24
4 Mallrat e qëndrueshme në Kosovë 2003-2005.....	26
4.1. Ndryshimet urbane dhe rurale.....	27
4.2. Vjetërsia e mallrave.....	28
5 Banimi dhe ndërtimi në Kosovë 2003-2005.....	36
5.1. Vlera e mirëqenies së shtëpive të poseduara.....	36
5.2. Ndërtimi.....	37
6 Trendet e varfërisë 2003/04 dhe 2005/06 në Kosovë.....	38
6.1. Varfëria në Kosovë.....	38

HYRJE

Enti i Statistikës së Kosovës (ESK) mat në mënyrë të vazhdueshme konsumin privat nëpërmjet Anketës së Buxhetit të Ekonomive Shtëpiake (ABESH). Këto statistika janë të nevojshme për të përcaktuar shportën për Indeksin e Çmimeve Konsumuese (IÇK), konsumin privat në Llogaritë Kombëtare (LLK) dhe analizimin e mirëqenies dhe varfërisë. Anketa gjithashtu mat edhe arsimimin, punësimin, kushtet e banimit, pronësinë e mallrave të qëndrueshme, ndërtimin dhe çështjet tjera që kanë të bëjnë me bizneset dhe kultivimin e tokës. Të dhënat janë mbledhur në tërë Kosovën gjatë një viti duke përfshirë 2 400 ekonomi familjare në vit të zgjedhura sipas rastit dhe në pajtim me standardet e BE-së dhe praktikat më të mira ndërkombëtare. Shkalla e përgjigjeve është më e lartë se 80 % nëse ekonomitë familjare të zëvendësuara janë konsideruar se nuk kanë dhënë përgjigje.

Progresi ekonomik në vitet e fundit do të definohej si përmirësim i kushteve të jetesës në krahasim me periudhën menjëherë pas luftës. Në këto rrethana, ABESH është e mirëseardhur për matjen e standardit jetësor, për matjen e bruto produktit kombëtar si dhe fitimin e ponderave të çmimeve konsumuese. Mostra ka shtrirje në zonat urbane dhe rurale, në tërë territorin e Kosovës.

Përpunimi dhe analizimi i të dhënave është bërë përmes programeve ACCESS dhe SPSS.

Pyetësori përmban informata mbi përbërjen demografike të ekonomisë shtëpiake duke përfshirë të dhëna individuale mbi secilin anëtar të ekonomisë familjare, si dhe të ardhurat, konsumin dhe shpenzimet, kushtet e banimit, pronësia e të mirave afatgjata, aktivitete në biznese dhe bujqësi, qasjen në infrastrukturën themelore dhe në shërbimet publike. Mbledhja e të dhënave nga ekonomitë familjare është bërë nga ana e punëtorëve të ESK-ës, në shtatë zyrat regjionale.

1 Konsumi i ekonomive shtëpiake në Kosovë 2003-2005

Konsumi është pjesë e rëndësishme e jetës së njerëzve. Pasuria dhe varfëria gjithashtu varen nga aspektet tjera në jetë, por niveli i konsumit dhe përmasat e tij janë qenësore për mirëqenien. Përderisa të hyrat fitohen nga individët, konsumi kryesisht ka të bëjë me ekonomitë shtëpiake. Alkooli dhe duhani, veshmbathjet, rekreacioni dhe disa gjëra tjera specifike mund të konsumohen individualisht, por pjesa më e madhe, si ushqimi, banimi dhe furnizimi shfrytëzohen së bashku nga pjesëtarët e ekonomive shtëpiake.

Konsumi klasifikohet sipas standardit të KKIQ-së (Klasifikimi i Konsumit Individual sipas Qëllimit) në harmonizim me Llogaritë Kombëtare dhe Indeksin e Çmimeve Konsumuese. Përveç disa përmirësimeve, standarde të njëjta janë aplikuar gjatë viteve, duke e bërë atë të krahasueshëm. Shumica e konsumit bazohet në mallrat e blera dhe shërbimet e paguara gjatë periudhës së referuar. Periudha e referuar është një muaj për konsumin ditor (të mbështetur me mbajtjen e shënimeve) dhe 12 muajt e fundit për mallrat e qëndrueshme.

Duke ju përmbajtur rekomandimeve ndërkombëtare, shpenzimet aktuale për banim nuk janë mbledhur, por vetëm qiraja e vlerësuar e bazuar në vlerësimin e vetë ekonomisë familjare. Në këtë dokument ne, do të fokusohemi në nivelin e konsumit për grupe të ndryshme konsumuese (ushqim, veshmbathje, banim, etj.) dhe pjesëmarrjen e tyre në konsumin e përgjithshëm.

Ne gjithashtu do t'i krahasojmë disa grupe të ekonomive shtëpiake. Ekonomitë shtëpiake me arsim të lartë dhe ekonomitë shtëpiake urbane mund të shihen si tregues për zhvillimin e ardhshëm të konsumit, pasi që gjithnjë e më shumë njerëzit po arsimohen dhe Kosova është duke u urbanizuar.

Shifrat në tekst janë rrumbullaksuar që të sinjalizojnë se, një mostër anketë mund t'i japë vetëm vlerat e përafërta.

1.1. Konsumi i përgjithshëm


Konsumi për ekonomi shtëpiake është rritur për rreth 5 % çdo vit duke arritur në 5 800 € në vitin 2005.

Ekonomitë shtëpiake urbane kanë një konsum më të lartë (6 400 €) se ekonomitë shtëpiake rurale, me 5 500 €. Rritja gjatë kohës ka qenë e njëjtë në të dy fushat.

Konsumi i përgjithshëm rritet kur ka më shumë arsimim. Ekonomitë shtëpiake ku kryefamiljarët kanë shkollën fillore apo më pak, konsumojnë 5 300 €, ndërsa ato më shkollë të mesme, konsumojnë 5 800 €. Ato me arsim të lartë kanë pasur një konsum të përgjithshëm prej 7 700 € në vitin 2005.

Ekonomitë shtëpiake rurale dhe më pak të arsimuara kanë nivel më të ulët të konsumit dhe më shumë pjesëtarë për ta ndarë atë.

Figura 1: Konsumi i përgjithshëm vjetor i ekonomive shtëpiake sipas lokalitetit dhe nivelit të arsimit 2003-2005, €



1.2. Ushqimi

Pjesa më e madhe e buxhetit shfrytëzohet për ushqim dhe është llogaritur 2 300 € për vitin 2005 apo 39 % të konsumit të përgjithshëm, që paraqet zvogëlim krahasuar me vitin 2003 ku konsumi i ushqimit ka qenë 47 %. Konsumi i ushqimit është pothuajse i njëjtë ndërmjet grupeve.

Pjesa më e vogël e buxhetit të ndarë për ushqim tregon një mirëqenie më të lartë. Siç është pritur, ekonomitë familjare urbane dhe me arsimim të lartë, kanë shkallë më të ulët të buxhetit për ushqim.

Pjesa për ushqim ka qenë ndërmjet 10 dhe 19 % në shtetet anëtare të EU në vitin 1999.

Figura 2: Konsumi vjetor i ushqimit nga ekonomitë shtëpiake sipas lokalitetit dhe nivelit të arsimit 2003-2005, €





Figura 3: Pjesa për ushqim nga konsumi i përgjithshëm sipas lokalitetit dhe nivelit të arsimit 2003-2005, %




1.3. Banimi

Banimi përbën pjesën e dytë më të madhe të buxhetit të ekonomive shtëpiake me 1 800 € dhe 31 % të buxhetit. Ushqimi dhe banimi së bashku përbëjnë më shumë se dy të tretat (70 %) të buxhetit.

Pjesa më e madhe e banimit është “qiraja e vlerësuar”. Një pjesë e vogël e ekonomive shtëpiake paguajnë qira. Pjesa e buxhetit e cila është ndarë për banim sillet nga 27 % për ekonomitë shtëpiake rurale deri 37 % për ato urbane. Në vitin 1999 banimi në shtetet anëtare të BE-së ka qenë nga 20 dhe 31 %.


Figura 4: Shpenzimet për banim sipas lokalitetit dhe nivelit të arsimit 2003-2005, €



1.4. Rrobat dhe veshmbathjet

Një ekonomi shtëpiake mesatare shpenzon 340 € në vit për rroba dhe veshmbathje apo 6 % të buxhetit. Pjesa e buxhetit që ndahet për rroba sillet prej 5 – 7 %, krahasuar me 5 – 9 % brenda BE-së në 1999.

Figura 5: Shpenzimet për rroba dhe veshmbathje sipas lokalitetit dhe nivelit të arsimit 2003-2005, €




1.5. Transporti

Transporti ka pasur ngritje gjatë viteve 2003, 2004 dhe 2005.

Pjesa e buxhetit të ndarë për transporte në vitin 2005 ka qenë 5 % për ekonomitë shtëpiake urbane ndërsa 7 % për ato rurale. Ekonomitë shtëpiake me arsimim të lartë shfrytëzojnë 7 % të buxhetit të tyre në transporte..

Në BE në vitin 1999 pjesa e buxhetit për transporte ka qenë ndërmjet 10 e 17 %.


Figura 6: Transporti i ekonomive familjare sipas lokalitetit dhe nivelit të arsimit 2003-2005, €



1.6. Mobiliet

Blerja e mobilieve është zvogëluar në vitin 2004, por është rritur në vitin 2005. Një ekonomi shtëpiake mesatare shpenzon 200 € në vit, ndërsa ato me arsim të lartë shpenzojnë 300 €. Pjesa e buxhetit të ndarë për mobile ishte 4 % në vitin 2005, ndërsa në vendet e BE ishte 5 - 8 % në vitin 1999.


Figura 7: Mobiliet sipas lokalitetit dhe nivelit të arsimit 2003-2005, €



1.7. Konsumi “kryesor”

Pesë kategoritë kryesore të konsumit më të lartë (ushqimi, banimi, rrobat dhe veshmbathjet, transporti dhe mobiliet) paraqesin 86 % të konsumit të përgjithshëm. Shtatë grupet tjera të konsumit kanë pasur përqindje më të vogël.

Figura 8: Pesë kategoritë kryesore të konsumit sipas lokalitetit dhe nivelit të arsimit, % e përgjithshme



1.8. Alkooli dhe duhani

Në buxhetin e përgjithshëm të ekonomisë shtëpiake alkooli dhe duhani marrin pjesë me 4 % apo 229 €. Ky konsum është rritur në vitin 2005. Në BE ky konsum sillet ndërmjet 2 deri në 7 %. Të gjithë njerëzit së bashku konsumonin 1.6 miliardë cigare në vitin 2005, krahasuar me 2.8 miliardë në vitin 2002/3. Më një çmim prej 0.5 € për pako në 2002/3 dhe 0.7 € në 2005, konsumi i përgjithshëm vjetor ka qenë 56 milion € në 2005 dhe 71 milion € në 2002/3. Përqindja e duhanxhinjve është zvogëluar për 4 % si tek meshkujt ashtu edhe te femrat.

Figura 9: Konsumi i alkoolit dhe i duhanit sipas lokalitetit dhe nivelit të arsimit 2003-2005, €





Tabela 1: Përqindja e duhanxhinjve në popullatë, sipas gjinisë dhe konsumit ditor të cigareve, % e popullatës e moshës 16 vjeç dhe më të moshuar

	Meshkujt		Femrat		Total	
	2002	2005	2002	2005	2002	2005
1 deri 10	2	2	2	2	2	2
11 deri 20	20	22	5	3	13	12
21+	14	8	2	0	8	3
Nr. përgj. i duhanxhinjve	36	32	9	5	22	18

1.9. Shëndetësia

Shpenzimet për shëndetësi janë rritur mjaft shumë. Ekonomitë shtëpiake më arsimim të lartë shpenzojnë më shumë për shëndetësi se sa ato me nivel më të ulët të arsimit.


Figura 10: Shpenzimet për shëndetësi sipas lokalitetit dhe nivelit të arsimit 2003-2005, €



1.10. Komunikacioni

Shpenzimet për komunikacion gjithashtu janë rritur shumë gjatë këtyre tri viteve. Ekonomitë shtëpiake urbane dhe ato me shkollim të lartë shpenzojnë më shumë për komunikacion.

Figura 11: Komunikacioni sipas lokalitetit dhe nivelit të arsimit 2003-2005, €




1.11. Rekreacioni

Kulmi i shpenzimeve për të gjitha ekonomitë shtëpiake ka qenë viti 2004. Në vitin 2005 ekonomitë shtëpiake urbane kanë shpenzuar më tepër për rekreacion.

Figura 12 tregon se familjet me arsim të lartë kanë pasur një ekonomi më të keqe në vitin 2005 krahasuar me 2004.


Figura 12: Shpenzimet për rekreacion sipas lokalitetit dhe nivelit të arsimit 2003-2005, €



1.12. Arsimi

Edhe shpenzimet për arsim gjithashtu kanë arritur kulmin në vitin 2004, sidomos ekonomitë shtëpiake me arsimim të lartë.


Figura 13: Shpenzimet për arsim sipas lokalitetit dhe nivelit të arsimit 2003-2005, €



1.13. Hotele dhe restorante

Shpenzimet për hotele dhe restorante kanë pasur parametra të njëjtë me rekreacionin si gjatë kohës ashtu edhe ndërmjet grupeve.


Figura 14: Shpenzimet për hotele dhe restorante sipas lokalitetit dhe nivelit të arsimit 2003-2005, €



1.14. Mallrat të tjera

Ky grup është një përzierje e kujdesit për rregullim të flokëve, mallrave për nevoja personale, shpenzime për sigurime dhe shpenzime tjera financiare. Ato janë rritur mjaft shumë për të gjitha grupet e ekonomive shtëpiake.

Figura 15: Shpenzimet tjera sipas lokalitetit dhe nivelit të arsimit 2003-2005, €



1.15. Konkluzion

Ekonomia shtëpiake kosovare ngadal po transformohet nga dominimi i ushqimit në banim, veshmbathje dhe transport. Ekonomitë familjare urbane dhe ato me arsim të lartë janë më përpara në këtë aspekt dhe po e rrisin pjesën e buxhetit për komunikacion, arsim, rekreacion, hotele dhe restorante.

Tabela 2: Konsumi vjetor i ekonomive shtëpiake në Kosovë 2003-2005 sipas grupeve kryesore të konsumit, lokalitetit dhe arsimit të kryefamiljarëve të ekonomive familjare, € dhe % konsumit të përgjithshëm

Kosova	Ekonomitë familjare	Ushqimi	Alko & duhan	Veshmb	Banim	Mobilje	Shënd	Transp	Komu	Rekre	Arsim	Hotel & rest	Te tjera	Totali
2003	278 397	2 484 €	178	257	1 536 €	211	79	223	69	62	37	53	91	5 281 €
2004	274 371	2 320 €	176	307	1 806 €	128	122	274	91	77	82	64	116	5 563 €
2005	261 877	2 274 €	229	337	1 834 €	237	133	353	123	70	42	70	162	5 863 €
Urbane														
2003	94 332	2 249 €	189	233	2 060 €	219	77	189	122	78	20	78	107	5 621 €
2004	105 308	2 246 €	174	285	2 254 €	123	107	235	134	89	96	91	112	5 946 €
2005	105 120	2 121 €	216	354	2 384 €	225	128	341	162	120	57	104	186	6 399 €
Rurale														
2003	184 065	2 605 €	173	270	1 268 €	207	79	241	42	54	46	40	83	5 107 €
2004	168 964	2 366 €	177	320	1 528 €	131	132	298	65	70	73	47	119	5 326 €
2005	156 546	2 378 €	237	325	1 463 €	245	136	361	96	36	32	48	147	5 503 €
Arsim fillor apo me pak														
2003	131 599	2 454 €	185	235	1 323 €	198	85	207	48	49	32	28	83	4 927 €
2004	126 789	2 220 €	186	265	1 480 €	90	132	221	65	46	47	34	91	4 877 €
2005	115 943	2 274 €	243	277	1 506 €	216	134	301	99	22	33	44	151	5 300 €
Arsim të mesëm														
2003	108 976	2 451 €	168	254	1 576 €	207	74	214	71	66	38	44	90	5 252 €
2004	110 942	2 310 €	164	301	1 913 €	146	108	276	95	66	81	59	120	5 637 €
2005	104 725	2 210 €	221	328	1 858 €	235	122	335	124	74	42	66	151	5 766 €
Arsim të lartë														
2003	36 873	2 669 €	184	345	2 176 €	271	68	310	136	102	54	164	127	6 605 €
2004	36 455	2 695 €	175	469	2 621 €	208	133	454	169	221	208	181	192	7 728 €
2005	41 209	2 437 €	209	530	2 693 €	300	159	541	187	191	66	156	222	7 692 €
Kosova	Ekonomitë familjare	Ushqimi	Alko & duhan	Veshmb	Banim	Mobilje	Shënd	Transp	Komu	Rekre	Arsim	Hotel & rest	Te tjera	5 i madh
2003	278 397	47%	3%	5%	29%	4%	1%	4%	1%	1%	1%	1%	2%	89%
2004	274 371	42%	3%	6%	32%	2%	2%	5%	2%	1%	1%	1%	2%	87%
2005	261 877	39%	4%	6%	31%	4%	2%	6%	2%	1%	1%	1%	3%	86%
Urbane														
2003	94 332	40%	3%	4%	37%	4%	1%	3%	2%	1%	0%	1%	2%	88%
2004	105 308	38%	3%	5%	38%	2%	2%	4%	2%	1%	2%	2%	2%	86%
2005	105 120	33%	3%	6%	37%	4%	2%	5%	3%	2%	1%	2%	3%	85%
Rural														
2003	184 065	51%	3%	5%	25%	4%	2%	5%	1%	1%	1%	1%	2%	90%
2004	168 964	44%	3%	6%	29%	2%	2%	6%	1%	1%	1%	1%	2%	87%
2005	156 546	43%	4%	6%	27%	4%	2%	7%	2%	1%	1%	1%	3%	87%
Arsim fillor apo më pak														
2003	131 599	50%	4%	5%	27%	4%	2%	4%	1%	1%	1%	1%	2%	90%
2004	126 789	46%	4%	5%	30%	2%	3%	5%	1%	1%	1%	1%	2%	88%
2005	115 943	43%	5%	5%	28%	4%	3%	6%	2%	0%	1%	1%	3%	86%
Arsim të mesëm														
2003	108 976	47%	3%	5%	30%	4%	1%	4%	1%	1%	1%	1%	2%	90%
2004	110 942	41%	3%	5%	34%	3%	2%	5%	2%	1%	1%	1%	2%	88%
2005	104 725	38%	4%	6%	32%	4%	2%	6%	2%	1%	1%	1%	3%	86%
Arsim të lartë														
2003	36 873	40%	3%	5%	33%	4%	1%	5%	2%	2%	1%	2%	2%	87%
2004	36 455	35%	2%	6%	34%	3%	2%	6%	2%	3%	3%	2%	2%	83%
2005	41 209	32%	3%	7%	35%	4%	2%	7%	2%	2%	1%	2%	3%	85%

2 Konsumi privat në Kosovë 2003-2005

Ky publikim paraqet të dhënat makroekonomike nga ABEF 2003-2005. Në disa raste rezultatet ndryshojnë nga Llogaritë Kombëtare (LLK-të), pasi që LLK-të plotësohen më disa burime tjera të të dhënave dhe bëjnë disa përshtatje. Të dhënat janë grumbulluar sipas standardit ndërkombëtar-Klasifikimi i Konsumit Individual sipas Qëllimit (KKIQ).

Më një mostër paksa më të vogël rezultatet duhet të konsiderohen si të përafërta. Pa një regjistrim të ri të përgjithshëm të popullsisë është vështirë që të bëhet ndonjë vlerësim.

2.1. Trendet e konsumit

Sipas anketës konsumi i përgjithshëm privat përfshinë ushqimin e prodhuar vendor më një rritje prej 2.4 % nga viti 2003 në vitin 2004 dhe prej 1.3 % ndërmjet vitit 2004 dhe 2005.

Konsumi privat për ekonomi shtëpiake është rritur pothuajse 4 % ndërmjet vitit 2003 dhe 2004 dhe 6 % ndërmjet vitit 2004 dhe 2005. Konsumi për kokë banori është rritur për më shumë se 14 % nga viti 2003 në vitin 2005. Duke ndërlidhur parashikimet zyrtare me rritjen vjetore të popullsisë për 1.7 %, konsumi i përgjithshëm privat ndërmjet vitit 2003 dhe 2005 është rritur për 17 %. Në vitin 1999 konsumi i përgjithshëm në vendet e BE-së ka qenë ndërmjet 20 000 dhe 30 000 €.

Tabela 3: Konsumi i përgjithshëm privat në Kosovë 2003-2005

Viti	Milion €	Konsumi për ekonomi familjare €	Konsumi për kokë banori €
2003	1.493	5.400	840
2004	1.529	5.600	910
2005	1.549	5.900	950

2.2. Shpërndarja e konsumit

Pjesa më e madhe e buxhetit është shpenzuar në ushqim me 40 % të konsumit të përgjithshëm. E dyta është banimi me më shumë se 30 % dhe vendin e tretë e zënë transporti dhe rrobat me 6 %. Pjesa për ushqimin është zvogëluar gjatë viteve dhe kjo mund të shihet si një shenjë e një standardi më të lartë ekonomik. Konsumi i ushqimit në vitin 2003 është paksa mbivlerësuar, për shkak të mënyrës së ndryshme të matjes së ushqimit të prodhuar vendor krahasuar me vitet tjera. Rreth 10 % e konsumit të përgjithshëm përfshin ushqimin nga prodhimi vetanak.

Tabela 4: Shpërndarja e konsumit në Kosovë 2003-2005

Konsumi	(%)		
	2003	2004	2005
Ushqimi	48	43	40
Alkooli & duhani	3	3	4
Rrobat	5	5	6
Banimi	29	31	31
Mobilje	4	3	4
Shëndetësia	1	2	2
Transporti	4	5	6
Komunikacioni	1	2	2
Rekreacioni	1	1	1
Arsim	1	1	1
Hotele& restorante	1	1	1
Të ndryshme	2	2	3
Gjithsej	100	100	100
<i>Ushqimi i prodhuar vendor</i>	13	9	9

Tabela 5: Shpërndarja e konsumit në BE në vitin 1999

Konsumi	Min		Maks	
	(%)			
Ushqimi	10		19	
Alkooli & duhani	2		7	
Rrobat	5		9	
Banimi	20		31	
Mobilje	5		8	
Shëndetësia	1		6	
Transporti	10		17	
Komunikacioni	2		3	
Rekreacioni	5		15	
Arsim	0		2	
Hotele & restorante	4		10	
Të ndryshme	5		15	

Burimi: ABEF 1999, Eurostat

2.3. Konsumi i ushqimit

Ushqimi në Kosovë dominohet nga buka, ushqimi nga drithërat, produktet ditore dhe vezët, që kontribuojnë në pothuajse gjysmën e konsumimit të ushqimit (në vlerë). Më pas vijnë mishi dhe perimet (nga 12 %).

Tabela 6: Shpërndarja e konsumit të ushqimit në Kosovë 2003-2005

Konsumi	2003			2004			2005		
	(%)								
Buka dhe drithërat	22		21		23				
Mishi	12		13		12				
Peshku	1		1		1				
Produktet ditore, vezët	23		22		21				
Vajrat dhe yndyrat	4		5		4				
Frutat	6		7		7				
Perimet	13		13		12				
Sheqeri dhe ëmbëlsirat	6		5		6				
Produktet e ushqimit	5		5		5				
Pijet jo alkoolike	8		9		9				
Ushqimi i përgjithshëm.	100		100		100				

2.4. Konsumi dhe shpenzimet

Shpenzimi i konsumit është rritur për 8 % ndërmjet vitit 2003 dhe 2004 por pastaj ka mbetur i pandryshuar gjatë vitit 2005. Vlera e mirëqenies së shtëpive vazhdimisht po rritet për 3% në vit. Konsumi i prodhimeve vetanake (ushqimi i prodhuar vendor dhe i marrë, druri për ngrohje dhe rrobat) është zvogëluar. Shpenzimet jo konsumuese (udhëtimet jashtë vendit, dhuratat e dhëna brenda dhe jashtë Kosovës si dhe të gjitha tatimet) kryesisht janë rritur nëpërmjet vendosjes së tatimit në rroga dhe vjeljes së rritur të tatimit në vetura.

Tabela 7: Konsumi dhe shpenzimet në Kosovë 2003-2005, miliona €

Viti	Milion €	Konsumi për ekonomi familjare €	Konsumi për kokë banori €
2003	1.493	5.400	840
2004	1.529	5.600	910
2005	1.549	5.900	950

3 Të hyrat private në Kosovë 2003-2005

3.1. Të hyrat kryesore të ekonomive familjare

Rrogat nga sektori publik janë burimi më i rëndësishëm i të hyrave në Kosovë dhe janë burimi kryesor për gati një të tretën e ekonomive familjare. Burimi tjetër më i rëndësishëm janë rrogat nga sektori privat.

Pothuajse një nga dhjetë ekonomitë familjare jeton nga paratë e dërguara nga jashtë.

Shumica e ekonomive familjare kanë burime të përziera të të hyrave, prandaj të hyrat e tanishme japin një pasqyrë të ndryshme.

Tabela 8: Burimi kryesor i të hyrave për ekonomitë familjare në Kosovë, % e ekonomive familjare

Burimi i të hyrave	2005	
	2005	2002/2003 (%)
Rrogat nga sektori publik	30	35
Rrogat nga sektori privat	16	18
Bujqësia	10	11
Biznesi	9	3
Punësim i përkohshëm	9	9
Dërgimi i parave nga jashtë	9	8 ¹
Pensionet	7	7
Ndihmë sociale	7	- ²
Të tjera	1	9
Totali	100	100

¹ Paratë e dërguara nga jashtë nuk janë veçuar në ciklin e parë të anketës.

² Ndihma sociale nuk është paraqitur ndaras por ne variablen "Te tjera".

3.2. Burimet e të hyrave individuale

Të ardhura marrin 316 000 meshkuj dhe 114 000 Femra. Vetëm 1 % e të hyrave janë sipas llojit, që do të thotë se paguhen apo jepen në formë të mallrave dhe shërbimeve.

Burimi kryesor i të hyrave janë rrogat nga punësimi i rregullt që përbëjnë rreth gjysmën e të hyrave të përgjithshme (51%). Rreth 6 % janë fituar nga puna e përkohshme. Të hyrat neto nga bizneset e një shkalle më të vogël përbëjnë 9 % të të hyrave të përgjithshme dhe nga bujqësia 6 %.

Burimi i dytë më i madhi janë paratë e gatshme të dërguara nga jashtë nga pjesëtarët e ekonomive familjare (10%), më një shtesë prej 3 % nga të tjerët jashtë vendit. Pensionet nga Kosova përbëjnë 5 % dhe pensionet nga jashtë 3 %.

Femrat fitojnë vetëm 18 % të të hyrave të përgjithshme. Rrogat nga punësimi i rregullt janë më të rëndësishme për femrat sesa për meshkujt. Pensionet nga Kosova përbëjnë burimin e dytë më të rëndësishëm për femrat me 15 % krahasuar me vetëm 3 % për meshkujt.

Arsimimi ka ndikim kryesor në burimet e të hyrave. Arsimimi më i madh shpie në më shumë të ardhura nga punësimi i rregullt. Ata me shkollë fillore apo më pak në masë të konsiderueshme duhet të jetojnë nga pensionet, bujqësia dhe mbështetja nga jashtë. Natyrisht ekziston një korrelacion i përafërt ndërmjet arsimimit dhe moshës.

Njerëzit më shkollë të mesme sigurojnë 15 % të të hyrave të tyre nga bizneset. Popullata serbe është shumë pak e angazhuar në biznese, e më tepër në bujqësi. Një e katërta e të hyrave të serbëve përbëhet nga pensionet me 15 % nga Kosova dhe 10 % nga jashtë. Shqiptarët marrin më shumë mbështetje nga jashtë.

Tabela 9: Burimet e të hyrave në Kosovë, % e të hyrave


Burimi i të hyrave	Meshkuj			Femra			Të gjithë (%)		
Rrogat nga punësimi i rregullt	51			58			53		
Rrogat nga puna e përkohshme	7			1			6		
Të hyrat nga biznesi	11			1			10		
Të hyrat nga bujqësia	3			1			3		
Nga anëtarët e ngushtë jashtë vendit	10			12			10		
Nga të tjerët jashtë vendit	3			3			3		
Pensionet nga Kosova	4			15			5		
Pensionet nga jashtë	3			2			2		
Para të dërguara nga Kosova	1			1			1		
Të hyrat nga qiraja	2			1			2		
Mirëqenie sociale	2			3			2		
Lotaritë	0			0			0		
Të tjera	2			1			2		
Pagat në natyrë	1			1			1		
Totali %	100			100			100		
Totali në milion €	765 M€			170 M€			935 M€		

Tabela 10: Burimet e të hyrave sipas nivelit më të lartë të arsimit


Burimi i të hyrave	(%)		
	Fillor	Mesëm	Lartë
Rrogat nga punësimi i rregullt	21	60	83
Rrogat nga puna e përkohshme	9	6	1
Të hyrat nga biznesi	4	15	6
Të hyrat nga bujqësia	8	0	0
Pensionet nga Kosova	14	1	2
Pensionet nga jashtë	7	1	1
Mirëqenie sociale	5	2	0
Dërgimi i parave nga jashtë	25	8	3
Të tjera	6	6	4

Figura 16: Burimet e të hyrave sipas përkatësisë etnike

Shqiptarët



Serbët



3.3. Nivelet e të hyrave

Një përfitues i të hyrave mesatare ka marrë 2 032 € në vitin 2005. Meshkujt kanë marrë 2 200 krahasuar me femrat që kanë marrë vetëm nga 1 500 € në vit. Serbët fitojnë vetëm 1 400 € në vit krahasuar me 2 100 sa fitojnë shqiptarët. Arsimimi është mirë i koordinuar me të hyrat. Akademikët marrin tri herë më shumë se njerëzit pa arsimim. Punëdhënësit kanë të hyrat më të larta me 4 700 €, pensionistët dhe të papunët më të ulëta.

3.4. Pabarazia gjinore


Femrat kanë të hyra shumë më të ulëta se meshkujt, si grup dhe si mesatare individuale. Si shpjegim mund të jetë vëllimi i ndryshëm i punëve sesa pagat e padrejta.

Tabela 11: Të hyrat mesatare nga punësimi 12 mujor sipas gjinisë, €

Të hyrat	Meshkuj	Femra	Të gjithë
Rrogat për punësimin 12 mujor	2.850 €	2.400 €	51%

Meshkujt fitojnë pothuajse 20% më shumë se femrat brenda periudhës 12 mujore të punësimit.

Figura 17: Mesatarja e të hyrave personale vjetore sipas gjinisë, moshës, përkatësisë etnike, arsimit dhe veprimtarisë ekonomike




4 Mallrat e qëndrueshme në Kosovë 2003-2005

Konsumi kryesisht matet në ABESH si mallrat e blera dhe shërbimet e paguara gjatë një periudhe të referuar kohore. Për konsumin ditor është shfrytëzuar periudha një mujore, ndërsa për mallrat e qëndrueshme është aplikuar periudha 12 mujore

Pothuajse të gjitha ekonomitë familjare (97%) kanë se paku një TV, që paraqet një rritje prej 5% nga viti 2003. Më së shumti është rritur numri i telefonave celularë, nga 46 % në 68 %.


Figura 18: Mallrat e qëndrueshme më të kërkuara në Kosovë, përqindja e ekonomive familjare në posedim të mjeteve



4.1. Ndryshimet urbane dhe rurale

Ekonomitë shtëpiake urbane kanë më shumë nga të gjithë artikujt përveç stufave të druve. Megjithatë, ndryshimi ndërmjet posedimit të veturave dhe TV-ve është jashtëzakonisht i madh.

Figura 19: Mallrat e qëndrueshme më të kërkuara sipas lokalitetit, përqindja e ekonomive shtëpiake në posedim të artikujve



4.2. Vjetërsia e mallrave

Shumica e veturave janë blerë pas vitit 1999 duke arritur kulmin në vitin 2000.

Figura 20: Numri i ekonomive shtëpiake në posedim të veturave sipas lokalitetit dhe vitit të blerjes




Figura 21: Posedimi i gjeneratorëve sipas lokalitetit dhe vitit të blerjes, ekonomitë shtëpiake




Figura 22: Posedimi i ujëngrohësve sipas lokalitetit dhe vitit të blerjes, ekonomitë shtëpiake




Figura 23: Posedimi i frigoriferëve sipas lokalitetit dhe vitit të blerjes, ekonomitë shtëpiake




Figura 24: Posedimi i ngrirësve sipas lokalitetit dhe vitit të blerjes, ekonomitë shtëpiake




Figura 25: Posedimi i rrobalarësve sipas lokalitetit dhe vitit të blerjes, ekonomitë shtëpiake




Figura 26: Posedimi i enëlarësve sipas lokalitetit dhe vitit të blerjes, ekonomitë shtëpiake




Figura 27: Posedimi i thithëseve elektrike sipas lokalitetit dhe vitit të blerjes, ekonomitë shtëpiake




Figura 28: Posedimi i TV-ve sipas lokalitetit dhe vitit të blerjes, ekonomitë shtëpiake




Figura 29: Posedimi i videove sipas lokalitetit dhe vitit të blerjes, ekonomitë shtëpiake




Figura 30: Posedimi i satelitëve sipas lokalitetit dhe vitit të blerjes, ekonomitë shtëpiake




Figura 31: Posedimi i radiove sipas lokalitetit dhe vitit të blerjes, ekonomitë shtëpiake




Figura 32: Posedimi kompjuterëve sipas lokalitetit dhe vitit të blerjes, ekonomitë shtëpiake





Figura 33: Posedimi i telefonave mobil sipas lokalitetit dhe vitit të blerjes, ekonomitë shtëpiake



Parametrat janë pak a shumë të ngjashme në zonat urbane dhe rurale të Kosovës, duke arritur kulmin në vitin 2000. Vetëm për kompjuterë dhe enëlarëse zonat urbane janë më përpara. Pjesa më e madhe e mallrave nuk janë më të vjetra se pesë vjet.

Tabela 12: Posedimi i pajisjeve të ekonomive shtëpiake në vitin 2003 dhe 2005 sipas lokalitetit, % e ekonomive shtëpiake

Pajisja/mjeti	2005 Kosovë	Urbane	Rurale	2003 Kosovë	Urbane	Rurale
TV	97	98	96	92	96	90
Stufë me dru	90	78	98	94	87	97
Hekur për hekurosje	84	91	80	85	91	82
Frigorifer	84	94	77	85	93	81
Thithëse elektrike	76	87	68	77	86	73
Shporet elek./me gaz	73	89	62	76	89	70
Ujëngrohës	69	83	60	72	83	66
Rrobalarëse	69	84	59	69	83	62
Telefona mobil	68	72	66	46	48	45
Radio, audio pajisjet	61	67	58	70	75	68
Ngrirës	58	67	53	67	73	64
Satelit	58	68	51	64	76	59
Veturë	54	56	54	50	48	51
Ventilator	40	57	30	40	52	33
Video	40	50	34	47	56	42
Gjenerator	12	15	9	5	7	5
Kompjuter	9	17	3	5	9	3
Makinë qepëse	7	10	6	17	16	17
Pajisje tjera fotografike	7	11	4	11	14	10
Biçikleta	7	10	5	12	13	12
Enëlarëse	6	12	2	5	9	2
Mikrovalë	5	10	2	3	5	2
Kamion	3	2	4	4	2	5
Rezervuar për ujë	2	2	2	4	5	4
Makinë tharëse	2	3	1	5	6	4
Kamerë	2	3	1	4	4	4
Klimë/kondicioner	1	1	0	2	2	2
Motoçikletë/skuter	0	1	0	-	-	-
Video kamerë	0	1	0	1	2	1

Tabela 13: Posedimi i pajisjeve të ekonomive shtëpiake sipas vitit të prodhimit, ekonomitë shtëpiake

Kosova	-1989	1990-1994	1995-1998	1999	2000	2001	2002	2003	2004
Shporet elek./me gaz	35 901	26 598	23 163	31 752	32 090	16 061	10 124	7 846	4 772
Mikrovalë	475	19	1 559	2 192	2 784	886	2 109	1 670	1 233
Stufë me dru	17 046	22 845	30 221	58 973	49 264	15 573	15 250	14 027	10 580
Gjenerator	581	328	1 139	1 819	5 121	4 538	5 723	6 406	4 101
Ujëngrohës	23 695	23 193	24 846	34 450	32 107	14 757	13 067	6 828	6 078
Rezervuar për ujë	1 423	361	330	881	1 169	568	553	695	
Frigorifer	26 279	30 434	28 634	31 153	43 029	27 731	16 574	7 982	5 810
Ngrirës	16 167	23 947	27 276	12 592	31 911	16 073	13 500	7 207	3 931
Rrobalarëse	15 046	19 389	22 928	16 033	40 895	22 618	18 723	13 022	7 240
Makinë tharëse	710	475	449	519	603	1 208	131	619	73
Hekur për hekurosje	15 997	26 594	24 673	38 779	66 225	17 648	12 703	8 815	5 268
Enëlarëse	204	343	763	1 814	4 607	2 204	2 550	2 012	680
Ventilator	7 674	12 832	18 989	17 493	26 646	9 105	5 846	3 416	2 957
Klimë/kondicioner	181	67	298	47	190	221	219	313	
Thithëse elektrike	11 741	22 679	29 098	38 263	49 439	15 412	13 550	9 991	5 770
Makinë qepëse	7 458	4 129	1 436	380	1 864	1 958	1 026	656	359
TV	17 960	25 650	20 067	68 190	59 211	26 060	17 291	9 170	7 547
Video	4 810	7 918	14 684	24 136	24 393	15 225	7 295	3 708	2 294
Satelit	3 367	16 683	31 859	28 133	34 437	17 629	12 734	4 021	1 349
Radio, audio pajisjet	18 986	19 574	16 762	43 447	33 190	11 430	6 710	5 890	3 700
Kamerë		55	517	167	1 823	592	657	360	377
Video kamerë	99				49	156	81	50	310
Pajisje tjera fotograf.	681	938	1 808	828	5 955	3 712	1 702	1 442	926
Kompjuter		162	1 068	966	5 046	3 028	4 640	3 801	1 981
Tel. mobil	1 129	399	1 597	14 256	28 141	22 807	47 393	42 432	16 006
Veturë	8 334	5 616	9 479	11 743	38 900	21 938	20 286	12 570	9 965
Kamion	935	358	186	490	1 776	1 501	1 424	1 468	521
Motoçikletë/skuter	422		103	160	262		15		118
Biçikletë	517	1 715	2 055	1 493	3 900	2 307	2 213	1 705	1 158

(vazhdimi i tabelës)

Urbane	-1989	1990-1994	1995-1998	1999	2000	2001	2002	2003	2004
Shporet elek./me gaz	22 307	16 111	11 884	13 620	13 249	5 131	4 934	3 199	2 032
Mikrovalë	298	19	1 501	1 731	1 842	886	1 666	1 386	780
Stufë me dru	8 333	12 191	12 982	15 492	16 144	5 548	4 813	3 498	2 978
Gjenerator	404	328	322	1 126	2 855	2 482	3 155	2 578	2 242
Ujëngrohës	18 631	14 960	13 541	13 644	10 179	5 413	4 967	2 576	2 907
Rezervuar për ujë	594	92	245	208	242	259	409	407	
Frigorifer	16 350	18 799	15 452	13 285	14 478	9 126	5 811	2 981	1 270
Ngrirës	11 275	13 880	15 847	4 578	12 092	5 370	3 827	2 269	1 250
Rrobalarëse	10 978	12 785	14 452	6 533	17 934	9 382	7 560	5 307	2 365
Makinë tharëse	324	388	449	232	303	394	131	326	73
Hekur për hekurosje	11 831	14 893	12 243	13 822	21 724	7 350	5 553	3 983	2 194
Enëlarëse	204	299	763	1 814	3 610	1 661	2 236	1 631	569
Ventilator	6 387	8 446	11 473	8 952	12 343	4 470	3 343	1 847	1 584
Klimë/kondicioner	181	67	170	47	190	198	219	269	
Thithëse elektrike	8 545	12 502	16 405	14 714	19 106	6 566	5 562	4 155	2 566
Makinë qepëse	4 391	2 636	884	47	609	466	655	343	
TV	8 662	12 494	9 451	30 939	19 358	8 724	6 167	3 727	2 216
Video	3 524	4 968	9 480	13 438	9 893	5 597	2 694	1 605	1 018
Satelit	2 270	8 501	22 711	11 896	11 891	6 841	4 619	2 193	263
Radio, audio pajisjet	9 254	9 972	7 923	20 725	9 986	4 530	3 198	2 938	974
Kamerë		55	212	167	1 376	495	586	360	197
Video kamerë	99				49	156	81	50	129
Pajisje tjera fotograf.	563	685	1 118	670	3 976	1 966	1 280	810	439
Kompjuter		162	678	879	4 049	2 374	3 531	3 211	1 692
Tel. mobil	285	258	1 079	6 683	12 140	9 893	20 860	18 010	5 209
Veturë	3 869	3 412	4 570	4 570	13 868	10 159	7 440	5 731	3 886
Kamion	103	31	51	26	698	104	705	110	115
Motoçikletë/skuter			103	160	262		15		118
Biçikletë	460	1 298	1 839	1 114	1 510	924	1 519	581	805
Rurale	-1989	1990-1994	1995-1998	1999	2000	2001	2002	2003	2004
Shporet elek./me gaz	13 594	10 465	11 279	18 043	18 841	10 930	5 190	4 646	2 740
Mikrovalë	177		58	461	942		444	283	453
Stufë me dru	8 713	10 654	17 140	43 391	33 119	10 003	10 437	10 529	7 602
Gjenerator	177		817	693	2 266	2 055	2 568	3 829	1 860
Ujëngrohës	5 063	8 234	11 305	20 715	21 928	9 344	8 100	4 253	3 171
Rezervuar për ujë	829	269	85	673	927	310	144	289	
Frigorifer	9 929	11 613	13 182	17 868	28 461	18 605	10 763	5 002	4 540
Ngrirës	4 892	10 067	11 428	7 992	19 819	10 703	9 672	4 937	2 681
Rrobalarëse	4 068	6 603	8 476	9 499	22 871	13 214	11 163	7 715	4 874
Makinë tharëse	387	87		286	300	814		293	
Hekur për hekurosje	4 166	11 700	12 430	24 868	44 501	10 298	7 150	4 809	3 074
Enëlarëse		44			997	543	314	381	111
Ventilator	1 287	4 386	7 516	8 541	14 190	4 635	2 503	1 569	1 374
Klimë/kondicioner			128					44	
Thithëse elektrike	3 195	10 177	12 671	23 550	30 243	8 846	7 987	5 836	3 204
Makinë qepëse	3 067	1 493	552	332	1 255	1 491	372	313	359
TV	9 299	13 156	10 595	37 161	39 852	17 336	11 124	5 344	5 331
Video	1 286	2 950	5 204	10 608	14 499	9 628	4 601	2 103	1 276
Satelit	1 097	8 182	9 148	16 237	22 546	10 788	8 115	1 828	1 086
Radio, audio pajisjet	9 732	9 602	8 817	22 632	23 204	6 899	3 512	2 951	2 726
Kamerë			305		447	97	72		180
Video kamerë									180
Pajisje tjera fotograf.	118	253	690	158	1 979	1 745	422	632	486
Kompjuter			390	87	996	654	1 109	590	289
Tel. mobil	844	142	517	7 573	16 001	12 914	26 443	24 421	10 797
Veturë	4 465	2 205	4 909	7 173	25 032	11 778	12 755	6 839	6 079
Kamion	832	327	135	463	1 077	1 397	719	1 358	405
Motoçikletë/skuter	422								
Biçikletë	58	417	216	379	2 389	1 383	694	1 124	353


5 Banimi dhe ndërtimi në Kosovë 2003-2005

Shpenzimet e banimit zënë vendin e dytë në buxhetin e Kosovës me 31 % të konsumit të përgjithshëm të ekonomisë shtëpiake. Vetëm 1 % e ekonomive shtëpiake janë me qira.

5.1. Vlera e mirëqenies së shtëpive të poseduara

Në ABESH në pyetjen për vlerësimin e shtëpive të tyre, shumica (58 %) e ekonomive shtëpiake kanë deklaruar për 100 € në muaj. Vetëm 3 % kanë 400 € apo më shumë. Vlera mesatare vjetore është 1 420 € krahasuar me 1 260 € në vitin 2003, me një rritje prej 13 %.

Figura 34: Vlera mujore e shtëpive të banuara nga pronarët në vitin 2005, €



5.2. Ndërtimi

Rreth 4 % të ekonomive shtëpiake kanë bërë investime në shtëpitë e tyre në vitin 2005 krahasuar me 5 % në vitin 2003. Investimi mestar në vitin 2005 ishte 72 € krahasuar me 315 € në 2003. Shumica e parave (69 %) janë shfrytëzuar për blerjen e materialeve. Puna vetanake është vlerësuar të jetë 10 % e investimit të përgjithshëm dhe 21 % është e kontraktuar.

Burimi më i madhe i financimit të ndërtimit është pranimi i parave nga jashtë. Burim tjetër më i madh janë kursimet. Vetëm 14 % janë hua të marra nga bankat.

Tabela 14: Ndërtimi i shtëpive të përhershme për ekonomi shtëpiake në vitin 2003 dhe 2005, €

	2005	2002/2003
Të kontraktuara	15	51
Materialet e blera	50	206
Materialet vetanake të shfrytëzuara	1	10
Vlera e punës vetanake	6	48
Totali	72	315


Tabela 15: Burimet e financimit të ndërtimit 2005, %

	%
Ndihmë qeveritare (Subvencionet)	2
Kreditë bankare	14
Pranimi i parave nga jashtë	46
Kursimet dhe burimet tjera vetanake	37
Të tjera	1

6 Trendët e varfërisë 2003/04 dhe 2005/06 në Kosovë

6.1. Varfëria në Kosovë

Rreth 45 % e popullatës së Kosovës është e varfër³. Rreth 15 % e popullatës është vlerësuar se jeton në varfëri ekstreme. 18 % e popullatës është në rrezik që të kalojë nën vijën e varfërisë apo në pjesën e popullatës së varfër. Ky nivel i varfërisë nuk është i befasishtëm nëse merret parasysh zhvillimi i ngadalshëm ekonomik. Pa ndihmën e popullatës e cila gjendet në migrim, kjo gjendje do të ishte edhe më e vështirë.




Burimi: ABESH 2003/04 dhe 2005/06

Ekonomitë shtëpiake të cilat kanë numër më të madh të anëtarëve janë më të varfëra. Kjo mund të shihet edhe nga grafiku. Pra ekonomitë shtëpiake që kanë më shumë së shtatë anëtarë janë më të varfra.

³ Nxjerrja e rezultateve të analizave të varfërisë është bërë nga ekspertët e Bankës Botërore. Këto rezultate janë nxjerrur nga Anketa e Buxhetit të Ekonomive Shtëpiake (ABESH), të realizuara nga ESK-së.


Figura 35: Përqindja e varfërisë sipas madhësisë së ekonomisë shtëpiake



Burimi: ABESH 2003/04 dhe 2005/06

Ekonomitë shtëpiake të cilat kryefamiljarin e kanë të gjinisë femërore janë më të varfra. Gjithashtu si rrezik i shtimit të varfërisë është edhe papunësia e madhe. Siç shihet nga grafiku pjesa më e madhe e të varfërve është nga të papunësuarit, por edhe një pjesë e cila punon nuk është në situatë të mirë dhe jeton në varfëri.


Figura 36: Përqindja e varfërisë sipas statusit të punësimit



Burimi: ABESH 2003/2004 dhe 2005/2006

Shumica e të varfërve jeton në vise rurale. Në vitin 2005 kemi një zvogëlim të varfërisë në viset urbane prej 5 %, ndërsa në viset rurale kemi një ngritje prej 5 %. Varfëria në viset rurale kryesisht është e lidhur me mungesën e tokës, bagëtive dhe të pajisjeve bujqësore. Përqindja e varfërisë ndryshon shumë edhe në mes të regjioneve. Në vitin 2003, Mitrovica, Ferizaji, Gjakova dhe Prizreni kanë pasur një përqindje më të lartë të varfërisë. Ndërsa në vitin 2005 vetëm Mitrovica dhe Ferizaji kanë pasur përqindje më të lartë.

Figura 36: Përqindja e varfërisë së plotë dhe ekstreme sipas zonave urbane dhe rurale



Burimi: ABESH 2003/04 dhe 2005/06

Tabela 16: Varfëria sipas regjioneve

	<i>Niveli i varfërisë</i>	
	<i>2003-04</i>	<i>2005-06</i>
Gjakova	50.6	45.5
Gjilani	32.9	23.4
Mitrovica	60.1	68.8
Peja	36.8	40
Prizreni	46.3	40.5
Prishtina	35.1	40.6
Ferizaj	48.6	54.3
Gjithsej	43.7	45

Burimi: ABESH 2003/04 dhe 2005/06

Enti i Statistikës së Kosovës përshkrim i shkurtër

Enti i Statistikës së Kosovës, është Ent profesional, vepron që nga viti 1948 dhe ka kaluar disa faza historike, i strukturuar sipas rregullimit shtetëror të asaj kohe. Më 2 Gusht 1999, Enti ka rifilluar punën profesionale, si i pavarur në kuadër të Ministrisë së Shërbimeve Publike. Enti financohet nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës dhe donatorë për projekte të veçanta.

Enti i Statistikës së Kosovës vepron sipas Rregullores 2001/14 e cila ka hyrë në fuqi më 2 Korrik 2001. Një Master Plan afatmesëm është duke u përgatitur për zhvillimin e sistemit statistikor kompatibil me Statistikat Evropiane.

Struktura organizative e ESK-së, katër *Departamente prodhuese* (Departamenti i statistikave ekonomike dhe llogarive kombëtare, Departamenti i statistikave të popullsisë, Departamenti i statistikave sociale dhe Departamenti i statistikave të bujqësisë dhe ambientit), *shtatë Zyra Rajonale* (Gjakovë, Gjilan, Mitrovicë, Pejë, Prizren, Prishtinë dhe Ferizaj), *dy Departamente mbështetëse* (Departamenti i metodologjisë dhe teknologjisë informative dhe Departamenti i administratës), si dhe *Zyra e regjistrimit të popullsisë*, përbëjnë ndërtimin struktural të ESK-së.

Të punësuar janë gjithsej 134 punëtorë, prej tyre, 96 (71.6%) në seli të Entit, gjersa në Zyrat Rajonale, 38 (28.4%) .

Kemi mbështetje dhe bashkëpunim profesional me institucionet ndërkombëtare.

Enti i Statistikës së Kosovës ka një terren krejtësisht të mbuluar në shkallë vendi. Për implementim e Anketave në terren përdorim mostrën dhe metodologjinë adekuate. Gjatë grumbullimit të raporteve nga njësitë raportuese angazhohen; profesionistë, teknikë, administratorë, civilë të zyrave të vendit, regjistruar terreni nga Zyrat Rajonale.

Një ekip i ekspertëve vendorë dhe ndërkombëtar janë duke punuar në projektin e regjistrimit të popullsisë.

Misioni i Entit, është që të përmbush nevojat e përdoruesve me të dhëna statistikore objektive dhe analiza të rregullta në mënyrë që të përkrah departamentet qeveritare, t'u sigurojë informata të duhura për vendim-marrësit si dhe përdoruesit tjerë në Kosovë.

- **Adresa: Enti i Statistikës së Kosovës, Rr."Zenel Salihu" Nr.4, Prishtinë**
- **Telefonat:**
Qendra kryesore: +381 (0) 38 235 111
Drejtori: +381 (0) 38 235 545 ose +381 (0) 38 504 604 lok. 6572
- **Fax: +381 (0) 38 235 033**
- **E-mail: social@ks-gov.net**
- **Ueb-faqe: www.ks-gov.net/esk**